

## **Prof. Dr. Sabri LAÇI**

**Prof. Dr. Sabri LAÇI** është i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universiteti i Tiranës, që prej vitit 1983.

Ka përvojë pune 38 vjeçare si pedagog dhe studiues. Pas diplomimit në degën Histori dhe Gjeografi (FHF, UT), në vitin 1983, ka kryer studimet pasuniversitare, doktorale dhe pasdoktorale me fokus në gjeografinë humane, regjionale dhe mjedisore.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Gjeografinë rurale dhe të bujqësisë, Gjeografinë e Kosovës dhe të territoreve shqiptare përtej kufirit të RSH-së, Gjeografinë e Europës Juglindore, Historinë e mendimit gjeografik; çështjet gjeosociale dhe gjeoekonomike të hapësirës shqiptare në Ballkanin Perëndimor, ndikimin e ndryshimeve klimatike në popullsinë, vendbanimet dhe turizmin në RSH, zhvillimin e territoreve ndërkufitare, mjedisin dhe peizazhin, teknologjinë e mësimdhënies etj.

Ka marrë pjesë në shtatë projekte kombëtare dhe 14 ndërkombëtare (financuar nga UNDP, Banka Botërore, BE-ja, Programi LIFE, ERASMUS + etj.). Veçohet Projekti “Ndikimi i ndryshimeve klimatike në RSH dhe masat për adaptim”, ku është angazhuar rreth 15 vjet si ekspert për çështjet social-gjeografike dhe të turizmit.

Ka shërbyer si drejtuese i Katedrës së Gjeografisë Ekonomike (1992-‘95), i Seksionit të Gjeografisë Ekonomike dhe Regjionale (2003-2008), i Departamentit të Gjeografisë (1998-‘00, 2008-‘12, 2012-‘16), i FHF-së, UT (2017-2020, 2020 e në vazhdim).

Ka botuar pesë libra universitare, tri monografi (jashtë shtetit), Atlasin Gjeografik të Popullsisë së Shqipërisë (2008), 64 zëra në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1981 dhe 2008), 70 artikuj shkencor (25 në revista jashtë shtetit), materialet e shumicës së projekteve, si dhe mbi 20 artikuj në shtypin e përditshëm.

Aktualisht drejton FHF-në, është anëtar i Senatit Akademik të UT-së dhe koordinator lokal në dy projekte ndërkombëtare (ERASMUS +). Po punon për përgatitjen e monografisë “Kurbini: natyra, popullsia, ekonomia dhe mjedisi”.